



Pranimi / Dorezimi Prilazje / Prilazje Reference / Reference	31.05.2021	2021	1	Viti / god. Year
Organ / Institucioni Org / Inst.	No. Dekt / Prot. Dec. No.	Shprehja / Propoz. Proposal	Sasia / Koliciteti Quantity	
SKDMSHAK	2759/2021		115	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.383/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vendosur sipas Aktgjykimit A.nr.2734/2019 të datës 29.04.2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën e datës 10.09.2019 me numër A.nr.530/2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Besiana" p.nr. Komuna e Podujevës, kundër Vendimit me Nr.Prot.179 të datës 15.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 31.05.2021, mori këtë .

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.530/2019 e datës 10.09.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr.Prot.179 i datës 15.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Administrata Tatimore e Kosovës, me datën 17.05.2019 ka parashtruar kërkesën për fillim të rekrutimit tek Ministria e Administratës Publike, ndërsa Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike, me datën 24.05.2019, ka aprovuar kërkesën e Administratës Tatimore të Kosovës.

Administrata Tatimore e Kosovës duke u bazuar në autorizimin e lartcekur, me datën 28.05.2019 ka shpall konkursin e brendshëm për (avancim) për pozitën "Udhëheqës i Ekipit në ATK", në kuadër të Departamentit të Tatimpaguesve të Mëdhenj DTM, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili ka marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit Administrata Tatimore e Kosovës me datën 28.06.2019

ka bërë publikimin e njoftimin për kandidatin e suksesshëm në bazë të të cilës ankuesi nuk është kandidat i rekomanduar për pozitën e lartcekur.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 28.06.2019 për kandidatin e suksesshëm, me datën 24.07.2019, ka parashtruar ankesën me Nr.Prot:11-06-3073 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, tek Administrata Tatimore të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, me datë, 15.08.2019 ka nxjerr Vendim me Nr.Prot:179 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi njoftimin e datës 28.06.2019.

Ankuesi, i pakënaqur me Vendimin me Nr.Prot:179 të datës 15.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 10.09.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 4260/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 16.09.2019, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa me datën 14.10.2019, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa me datën 17.06.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 29.04.2021 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.2734/19, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 17.10.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 10.09.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Aktgjykimi A.nr.2734/19 i datës 29.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën me numër protokoli 4260/2019 të datës 10.09.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 24.07.2019 me Nr. Prot: 11-06-3072 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës; Formulari i vleresimit për vitin 2018 vitin 2017 dhe 2016; Vendimi i datës 15.08.2019 Komisionin për

Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës; Vendim i datës 05.09.2019; Konkursi i datës 28.05.2019; Përgjigje e datës 14.10.2019; Autorizmi i datë 24.05.2019; Miratimi për publikimin e rekrutimit i datë 27.05.2019; Vendimi nr.278 i datës 05.06.2019; Regjistri i kërësive të pranuar i datës 05.06.2019; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listë të ngushtë Form.MAP-SHCK-05; Njoftimi i kandidatëve për testim Form-MAP-SHCK-06; Regjistrimi përfundimtar sipas rezultateve të testit me shkrim Form.MAP-SHCK-05/b; Njoftimi për intervistën me gojë e datës 18.06.2019; Përmbledhja e vlerësimeve individuale Form.MAP-SHCK-09; Renditja përfundimtare Form.MAP-SHCK-10; Raporti final i rekomandimit nga komisioni përzgjedhës Form.MAP-SHCK-11; Njoftimi i datës 28.06.2019; Kërkesa për punësim i datë 31.05.2019; testi me shkrim i datës 13.06.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se, Administrata Tatimore e Kosovës me rastin e shpalljen së konkursit të brendshëm për pozitën "Udhëheqës i Ekipit ATK-së (1 pozitë), nuk është zhvilluar në pajtim me rregulloren dhe ligjin në fuqi, se përzgjedhja e kandidatit nuk është bërë në bazë të meritës për shkak të parregullsive të procedurës së rekrutimit-avancimit, se testi me shkrim nuk është përpiluar në pajtim me nenin 36 të rregullores së rekrutimit, sepse ka pasur pyetje të përsëritura, shkelje të nenit 9 që procedurën e rekrutimit ta inicion udhëheqësi i njësisë ku pozita është e lirë, shkelje e nenit 80 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe njoftimi për rezultatin e procedurës së rekrutimit nuk është bërë në pajtim me nenin 41 të Rregullores Nr. 02/2010.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se procedurat e rekrutimit-avancimit të brendshëm nuk janë zhvilluar në pajtim me rregulloren dhe ligjin në fuqi, si dhe testi me shkrim për pozitën "Udhëheqës i Ekipit ATK- 1 pozita" nuk është përpiluar në pajtim me nenin 36 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit për Shërbim Civil, mbi këtë bazë është konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës me datën 24.05.2019 ka pranuar aprovimin e kërkesës së datës 17.05.2019, për shpalljen e konkursit të brendshëm nga Ministria e Administratës Publike-Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil, i cili është shpallur me datën 28.05.2019 deri me datë 04.06.2019, ku kriteret e konkursit kanë qenë: *Diplomë Universiteti në Fakultetin Ekonomik , Juridik dhe Biznesi, si dhe me përvojë pune katër (4) vite punë profesionale*, ku ankuesi ka qenë pjesë e procedurës së rekrutimit dhe është përfshirë në listë të ngushtë , testim me shkrim dhe intervistën me gojë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin e ankuesit lidhur me përpilimin e testit me shkrim i cili pretendon se është në kundërshtim me dispozitat ligjore sepse ka pasur pyetje të përsëritura në testin me shkrim, ka konstatuar se pretendimi është i pa bazuar, sepse testi me shkrim për pozitën "Udhëheqës i Ekipit ATK-1 pozitë", është mbajtur me datën 13.06.2019 i cili ka qenë i përbërë nga tri (3) pjesë dhe se hartimi i tij është bërë në pajtim me nenin 36 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *"Pjesa e njohurive të përgjithshme. Në këtë pjesë, kandidatëve u parashtrohen 3 deri në 5 pyetje në formë eseje nga 150 deri 250 fjale, me*

qëllim të testimit të: njohurive dhe informatave të përgjithshme si dhe kapacitetit për shprehje me shkrim të koncepteve dhe mënyrës logjike, koncize dhe efektive.....1.2 Pjesa e aftësive të përgjithshme dhe të personalitetit, në këtë pjesë kandidatëve ju parashtrohen 10 deri 15 pyetje me përgjigje të shumëfishta,....1.3 Pjesa e njohurive që lidhen me vendin e punës. Në këtë pjesë kandidatëve u parashtrohen 15 deri 23 pyetje, të cilat janë 50 % me pyetje të shumëfishta dhe 50% me forme eseje....", e që në rastin konkret Kolegji ka konstatuar se testi me shkrim për kandidatet aplikues, ka qenë i përpiluar prej 3 pjesëve, ku në pjesën e parë janë përfshirë katër (4) ese, në pjesën e dytë pesëmbëdhjete (15) pyetje me përgjigje të shumëfishta, dhe në pjesën e tretë janë parashtruar gjashtëmbëdhjete (16) pyetje, prej tyre tetë (8) ese dhe tetë (8) pyetje me përgjigje të shumëfishta, ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se pyetjet janë përsëritur dhe kanë qenë të njëjta, Kolegji pas analizimit të testit me shkrim, ka konstatuar se tek pjesa e fundit e testit me shkrim konkretisht tek pjesa e njohurive që lidhen me vendin e punës pyetja e parë (1) ka qenë e hartuar në formë eseje dhe ka pasur për qëllim të flitet rreth misionit të ATK-së nga ana e kandidatëve aplikues, ndërsa në pyetjen e tetë (8) tek pjesa e aftësive të përgjithshme dhe personalitetit ka qenë pyetje me përgjigje të shumëfishtë dhe kandidatet është dashur që vetëm njëri nga përgjigjet e sakta ta rrumbullakojnë, andaj Kolegji pas vlerësimit dhe analizimit të testit me shkrim, ka konstatuar se përsëritja e pyetjeve të njëjta në testin me shkrim, nuk ka ndikuar në rezultatin përfundimtar dhe në renditjen e kandidatëve në listën e përzgjedhur, sepse testi me shkrim ka qenë i njëjtë për të gjithë kandidatet e që nuk ka qenë diskriminues për asnjërin nga kandidatet aplikues dhe mbi bazën e kësaj Kolegji ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil, me rastin e hartimit të testit me shkrim, nuk ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit për Shërbim Civil, andaj edhe mbi bazën e kësaj pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar dhe jo i qëndrueshëm.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil me rastin e përzgjedhjes së kandidatit të suksesshëm për pozitën "Udhëheqës i Ekipit ATK-1 pozitë", në Administratën Tatimore të Kosovës, ka grumbulluar më së shumti pikë gjithsejtë 84.20%, nga intervista me shkrim dhe me gojë, kurse ankuesi ka grumbulluar gjithsejtë 64.30% pikë, e që në rastin konkret komisioni ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "*Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë*".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.Prot:179 të datës 15.08.2019, ka vendosur në pajtim me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.


Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente,

brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.383/2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI


Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të përgjithshëm të administratës tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Administratës Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

